



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 633/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.08.2017, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "SEAD-SGS" sh.p.k., në procedurën e prokurimit, "Procedurë e Hapur", me objekt "Blerje Ushqime", me nr. REF-16034-06-01-2017, me fond limit 10,861,663 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër, e ndarë me lote me objekte si më poshtë vijon: *Loti I: "Blerje buke"*, me nr. REF-16056-06-01-2017, me fond limit 1,381,536 lekë (pa TVSH); *Loti II: "Blerje produkte mishi dhe bulmetra"*, me nr. REF-16058-06-01-2017, me fond limit 6,052,681 lekë (pa TVSH); *Loti III: "Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate"*, me nr. REF-16061-06-01-2017, me fond limit 3,427,446 lekë (pa TVSH).

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik "LEL" sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit në lidhje me Lotin I, Lotin II dhe Lotin III.

Ankimues:

"NIKA" sh.p.k.

Adresa: Bulevardi "Skënderbeg", pas kinema Millenium, Shkodër.

"LEL" sh.p.k.

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr.17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër

Adresa: Rruga "Bujar Bishanaku", Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 02.06.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Ushqime”, me nr. REF-16034-06-01-2017, me fond limit 10,861,663 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër, e ndarë me lote me objekte si më poshtë vijon: *Loti I: “Blerje buke”, me nr. REF-16056-06-01-2017, me fond limit 1,381,536 lekë (pa TVSH); Loti II: “Blerje produkte mishi dhe bulmetra”, me nr. REF-16058-06-01-2017, me fond limit 6,052,681*

lekë (pa TVSH); *Loti III: “Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate”*, me nr. REF-16061-06-01-2017, me fond limit 3,427,446 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 29.06.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 20.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Loti I me objekt “Blerje buke”

1. “LEL” sh.p.k.	1,095,120 lekë (pa TVSH)	skualifikuar
2. “SEAD-SGS” sh.p.k.	1,330,992 lekë (pa TVSH)	kualifikuar
3. “NIKA” sh.p.k.	1,347,840 lekë (pa TVSH)	kualifikuar

Loti II me objekt “Blerje produkte mishi dhe bulmetra”

1. “LEL” sh.p.k.	4,878,900 lekë (pa TVSH)	skualifikuar
2. “SEAD-SGS” sh.p.k.	5,568,180 lekë (pa TVSH)	kualifikuar
3. “NIKA” sh.p.k.	5,983,820 lekë (pa TVSH)	kualifikuar

Loti III me objekt “Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate”

1. “LEL” sh.p.k.	2,980,828 lekë (pa TVSH)	skualifikuar
2. “SEAD-SGS” sh.p.k.	3,071,525 lekë (pa TVSH)	kualifikuar
3. “NIKA” sh.p.k.	3,360,680 lekë (pa TVSH)	kualifikuar

II.4. Në datën 26.07.2017 operatori ekonomik ankimues “NIKA” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në lidhje me Lotin I, Lotin II dhe Lotin III, duke parashtruar të njëjtat pretendime për të tre Lotet, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Në bazë të informacioneve që ne disponojmë, rezulton se shoqëria “SEAD-SGS” sh.p.k. e cila është e renditur me ofertë më të ulët se e jona është kualifikuar padrejtësisht pasi nuk i plotëson kriteret e përcaktuara paraprakisht nga enti prokurues. Kështu ky subjekt paraqet disa mangësi. Së pari nuk ka paraqitur deklaratën mbi informacionin konfidencial sipas shtojcës së përcaktuar në DST. Së dyti, nuk ka fare bilancet e viteve 2014 dhe 2015. Së treti, nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitin 2014 – 2015. Së katërti, në lidhje me lotin I ky subjekt nuk ka paraqitur leje teknologjike për furrën e bukës. Të gjitha këto bëjnë që vlerësimi të jetë bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe rrjedhimisht nuk krijon besueshmëri kontraktimi. Aq më tepër që kontrata e furnizimit me ushqime është shumë sensitive për shkak të natyrës së vecantë që ka. Sa më sipër kërkohet nga ana juaj të rishikohet vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, të skualifikohet shoqëria “SEAD SGS” sh.p.k. dhe të shpallet fituese shoqëria “Nika” sh.p.k.

II.4.1. Në datën 02.08.2017 autoriteti kontraktor, me anë të shkresës Nr. 1287 Prot. datë 02.08.2017, i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “NIKA” sh.p.k., duke mos pranuar pretendimet e tij për asnjë nga Lotet objekt i procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4.2. Në datën 08.08.2017 operatori ekonomik ankimues “NIKA” sh.p.k ka paraqitur tre ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, në lidhje me Lotin I, Lotin II, Lotin III.

II.5. Në datën 20.07.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ”LEL” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në lidhje me Lotin I, Lotin II dhe Lotin III, për arsytet si më poshtë vijon:

“[...] - Operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qiraje, së cilës i mungojnë data dhe nr. Rep dhe si pasojë kjo kontratë është e pavlefshme.

- *Mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të objektit të marrë me qira, me adresë Rr. Mbreti Gent, L.Lugocezme, Shkodër.*
- *Operatori ekonomik nuk paraqet leje higjeno-sanitare për objektin e marrë me qira në Shkodër.*
- *Nuk plotëson pikën 10 të kapacitetit teknik ku thuhet; “për arsye se furnizimi do të jetë ditor dhe në orë të përcaktuara sipas grafikut bashkëngjitur DST kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tenderin e mësipërm duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni ose të kenë pikë kontakti në qytet si adresë të dytë, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës ligjor, i regjistruar në QKB e ofertuesit si adresë të dytë ushtrimi aktiviteti si dhe të jetë i pajisur me leje higjeno sanitare, pasi kontrata e qerasë për ambientin me shoqërinë Univers Frigo Darb sh.p.k. i mungon data, numri i repertorit dh koleksionit.*
- *Dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kontrate qeraje nuk vërteton pronësinë e ambientit nga qeradhënësi.*
- *Mungon leja higjenosanitare për ambientin me qira, pasi ju keni paraqitur autorizim për inspektim që nuk përfaqëson leje higjeno sanitare.*
- *Nga verifikimet e kryera pranë zyrës së tatimeve pranë Bashkisë Shkodër rezulton se subjekti juaj nuk është i regjistruar pranë kësaj zyre dhe rrjedhimisht nuk paguan detyrimet për ushtrimin e aktivitetit si adresë e dytë.*
- *Nga verifikimet e ekstraktit të QKR rezulton se ju ushtroni aktivitet në dy adresa ndërsa në vërtetimin e lëshuar nga OSHEE rezulton se paguani detyrimet vetëm për njërën adresë.*
- *Vërtetimi hipotekor për ambientin e marrë me huapërdorje nuk ka vulën e organit që ka lëshuar këtë vërtetim hipotekor.*

II.5.1. Në datën 26.07.2017 operatori ekonomik ankimues ”LEL” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, për Lotin I, Lotin II dhe Lotin III, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Sqarojmë se në kriteret kualifikuese nuk është specifikuar që ofertuesit duhet të paraqesin vërtetime në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike në lidhje me pikën e kontaktit. Në lidhje me kontratën sqarojmë se kontrata është konform rregullit pasi kontrata është e nënshkruar tek noteri, gjë e cila është e vërtetuar katërcipërisht pasi është nënshkruar edhe vulosur nga noteria respektive. Në lidhje me lejen higjeno sanitare, ky dokument është paraqitur në sistem e vërtetuar lehtësisht kjo, prandaj ky justifikim nuk mund të shërbejë si shkak për skualifikimin e ofertës tonë. Si konkluzion i kësaj ankesë, bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, bazuar në argumentat e sipërpërmedura gjykojmë se justifikimet e KVO-së nuk mund të shërbejnë si shkak për skualifikimin prandaj me këtë ankesë në kërkojmë të kualifikohemi dhe

njëkohësisht të shpallemi fitues. Sikurse theksuam këto janë arsye shumë devijonte për të skualifikuar një operator ekonomik i cili oferton me një çmim të ulët të argumentuar qëllimi për të cilin zhvillohet një procedurë prokurimi. Duke qenë se jemi brenda afateve kohore që përcakton ligji për ankesat, po paraqesim këtë ankesë me besimin për te fituar të drejtën e kualifikimit dhe të shpalljes si ofertë fituese.

II.5.2. Në datë 02.08.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankimues “LEL” sh.p.k. me anë të shkresës Nr. 1286 Prot. datë 02.08.2017., duke e refuzuar ankesën si dhe duke informuar autoritetin kontraktor se nuk i ka kundërshtuar të gjitha arsyet e skualifikimit.

II.5.3. Në datën 08.08.2017 pala ankimuese “LEL” sh.p.k ka paraqitur tre ankesa në lidhje me Lotin I, Lotin II dhe Lotin III, pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke ngritur edhe ato pretendime të cilat nuk i kishte ankimuar më parë pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 17.08.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresave nr.1348 prot., datë 17.08.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NIKA” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k., në Lotin I, Lotin II dhe Lotin III në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se “[...]Operatori ekonomik “Sead-SGS” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratën mbi informacionin konfidencial sipas shtojcës së përcaktuar në DST”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike për Lotin 1, Lotin II dhe Lotin III, pjesë përbërëse e tyre është Shtojca 5 “Lista e informacionit konfidencial” (Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti) (Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial).

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k., në sistemin elektronik për këtë procedurë rezulton se ky i fundit nuk e ka paraqitur Shtojcën 5.

III.1.3. Në dokumentat standarte të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, vërejmë se Shtojca 5, “Lista e Informacionit Konfidencial”, është vendosur si pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve me qëllim deklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të dokumenteve të cilët ata dëshirojnë që të mos bëhen publike kundrejt operatorëve të tjerë konkurrentë.

Gjithashtu, evidentohet se në këtë shtojcë është përcaktuar që është Shtojcë për t’u plotësuar nga

operatori ekonomik nëse është rasti, për të shënuar informacionin që operatori ekonomik dëshiron të mbahet konfidencial.

III.1.4. Neni 25 “*Fshehtësia e Procesit*”, i LPP përcakton se: “*Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale.*”

Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.

Përmes këtij rregullimi, i cili është ndikuar sa nga praktika aq edhe nga Direktivat e BE mbi fushën, legjislatori ka dashur t’iu vijë në ndihmë ekskluzivisht operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të një procedure prokurimi; mundësia që iu krijohet atyre për të ruajtur konfidencialitetin e mënyrës së prodhimit të mallrave apo teknologjinë që përdor kompania si dhe koston e prodhimeve të mallrave, apo edhe elementë të tjerë që mund të konsiderohen “sekrete tregtare”, nuk ka asnjë lidhje dhe nuk cënon asnjë interes të autoritetit kontraktor, përkundrazi, lehtëson dhe nxit pjesëmarrjen e sa më shumë pjesëmarrësve, duke rritur kështu konkurrencën, me rrjedhojë potencialisht të lartë uljen e çmimit të ofertave.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në situatën kur një operator ekonomik nuk e ka paraqitur shtojcën 5, në thelb, i vetmi subjekt i cënuar është vetë operatori ekonomik i pakujdesshëm, i cili, *a priori*, do ta ketë të vështirë të mbrojë informacionin (teknik, financiar apo ligjor) e paraqitur në këtë procedurë prokurimi por, nga ana tjetër, është në kundërshtim me *ratio* të legjislacionit mbi prokurimin publik që kjo mungesë të çojë në skualifikimin automatik të tij, duke qenë se nuk ka asnjë ndikim si në ofertën e tij edhe në qëllimin e autoritetit kontraktor, i cili është: garantimi i ekzekutimit me sukses të kontratës së shërbimit me sa më pak shpenzime.

Referuar arsyetimit të mësipërm, gjykojmë se pretendimi i operatorit ekonomik “NIKA” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “NIKA” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k., në Lotin I, Lotin II dhe Lotin III në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se “[...]nuk ka fare bilancet e viteve 2014 dhe 2015 dhe nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitin 2014 – 2015”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.2 “*Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

Loti I

- *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes kopje të çertifikuara të një ose me shumë bilanceve të tre viteve të mëparshme ,2014,2015,2016,te çertifikuara nga autoritetet përkatëse .*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes Vertetim nga Administrata Tatimore,per xhiron mesatare vjetore per vitet 2014,2015, 2016 ,ku vlere e xhiros vjetore ,te jete ne nje vlere jo me pak se prej 967 000(nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë)lekë.*

Loti II

- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes kopje të certifikuara të një ose me shumë bilanceve të tre viteve të mëparshme ,2014,2015,2016,te certifikuara nga autoritetet përkatëse.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes Vertetim nga Administrata Tatimore,per xhiron mesatare vjetore per vitet 2014,2015, 2016 ,ku vlera e xhiros vjetore ,te jete ne nje vlere jo me pak se 4 236 000(katërmilion e dyqind e tridhjetë e gjashtëmijë)lekë .

Loti III

- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes kopje të certifikuara të një ose me shumë bilanceve të tre viteve të mëparshme ,2014,2015,2016,te certifikuara nga autoritetet përkatëse .
- Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes Vertetim nga Administrata Tatimore,per xhiron mesatare vjetore per vitet 2014,2015, 2016 , ku vlera e xhiros vjetore ,te jete ne nje vlere jo me pak se 2 399 000 (dymilion e treqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë)lekë.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar :

- Pasqyrat Financiare të Vitit 2016
- Vërtetim Nr.34527/1 Prot datë 22.06.2017 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane me anë të së cilës vërtetohet se: *Tatimpaguesi “SEAD-SGS” në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitur në vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:*

Viti 2016

5 583 887 lekë

Public Health Sector

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]”

Në nenin 26 “Kontrata e Mallrave” pika 5 gërma “b” e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose
- b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet [...]”

III.2.4. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton se, operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregëtar shqiptar në datën 25.05.2016. Nisur nga kjo, operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. nuk ka paraqitur bilancet për vitet 2014, 2015, për shkak të mosekzistencës së tij dhe rrjedhimisht mos ushtrimit të aktivitetit në këtë periudhë të vitit. Gjithashtu në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e vërtetimit për xhiron mesatare vjetore për vitet 2014, 2015, në përlogaritje të mesatares, do të konsiderohet në shifrën 0 (zero) lekë, për shkak se shoqëria nuk ka ushtruar aktivitet gjatë kësaj periudhe.

III.2.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. rezulton se xhiro në vlerë mesatare për vitin 2016 është në vlerë 5.583.887 lekë, vlerë kjo më e madhe se vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për secilin Lot (I, II dhe III).

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur (si mësipër analizuar), kriteri për xhiron, përmbushet në vlerë nga operatori ekonomik ankimues, për tre vitet e fundit financiare në përputhje me parashikimet ligjore të sipërcituara. Gjithashtu edhe sa i takon bilanceve operatori ekonomik ankimues në pamundësi për të paraqitur bilancet për vitet 2014 dhe 2015 ka paraqitur bilancet për vitin 2016 vit në të cilin është krijuar si person juridik.

Komisioni vlerëson se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “NIKA” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k., me arsyen se: *“në lidhje me Lotin I ky subjekt nuk ka paraqitur leje teknologjike për furrën e bukës”*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8, Loti I, *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, pika 5, e dokumentave të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

[...]

“Leje Tekniko-Teknologjike për prodhim buke. Lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqesise dhe Ushqimit, Sherbimi i Inspektoriatit Kontrollit Ushqimor.”

III.3.2. Për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për leje Tekniko-Teknologjike për prodhim buke, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqesise dhe Ushqimit, Sherbimi i Inspektoriatit Kontrollit Ushqimor, operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. ka paraqitur:

- Vërtetim nr.393 Prot, datë 28.06.2017, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “SEAD-SGS”, me aktivitet Furrë buke, me adresë Lagja Qemal Stafa është subjekt që kontrollohet nga AKU Shkodër dhe plotëson kushtet tekniko teknologjike për ushtrimin e aktivitetit, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale Shkodër.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe 6, parashikohet se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) rezulton se operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor si më sipër cituar, pasi nga ana e tij është paraqitur Vërtetim lëshuar nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale

Shkodër në emër të subjektit “SEAD-SGS” sh.p.k. me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “SEAD-SGS” sh.p.k. plotëson kushtet tekniko teknologjike për ushtrimin e aktivitetit.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.3.6. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, është i vlefshëm duke plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “NIKA” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik “LEL” sh.p.k se në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimet të cilat janë ngritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk janë ngritur të gjitha edhe pranë autoritetit kontraktor, duke mos ndjekur kështu shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 7 parashikohet se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”* (pika 2) *“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme”* (pika 7).

Operatori ekonomik ankimes, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte paraqitur paraprakisht ankesë pranë autoritetit kontraktor për të gjitha pretendimet lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në të gjitha lotet, për këtë procedurë prokurimi, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankesë pranë autoritetit

kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP. Operatorët ekonomikë kanë mundësi vetëm të pakësojnë objektin e ankesës duke hequr dorë nga pretendime të cilat i kanë paraqitur së pari në autoritetin kontraktor por kursesi të shtojnë ato.

III.4.1. Neni 63, pika 1, e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull “*Të drejtat e personit të interesuar*” parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” Në nenin 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*” Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimesi edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me arsyet e skualifikimit të ankimeuara në autoritetin kontraktor, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi, për arsyet e tjera të skualifikimit nuk janë ngritur pretendime pranë autoritetit kontraktor, çka sjell se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimesin. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-së janë afate prekluzive. Këto afate, duke qenë afate prekluzive (dekadence), nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Sa më sipër, e drejta e ankimit për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike për shkak se nuk është ezauruar pranë autoritetit kontraktor ka rënë në decadence.

Public Health Sector

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “LEL” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “NIKA” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje Ushqime*”, me nr. REF-16034-06-01-2017, me fond limit 10,861,663 lekë (pa TVSH), në lidhje me Lotin I: “*Blerje buke*”, me nr. REF-16056-06-01-2017, me fond limit 1,381,536 lekë (pa TVSH); Lotin II: “*Blerje produkte mishi dhe bulmetra*“, me nr. REF-16058-06-01-2017, me fond limit 6,052,681 lekë (pa TVSH); Lotin III: “*Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate*”, me nr. REF-16061-06-01-2017, me fond limit 3,427,446 lekë (pa TVSH) zhvilluar në datën 29.06.2017, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.

2. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “LEL” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar, në lidhje me Lotin I, Loti II dhe Lotin III.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1362 protokoli Datë 08.08.2017;
Nr. 1363 protokoli Datë 08.08.2017;
Nr. 1364 protokoli Datë 08.08.2017;

Nr. 1365 protokoli Datë 08.08.2017;
Nr. 1366 protokoli Datë 08.08.2017;
Nr. 1367 protokoli Datë 08.08.2017;

